

Fletëudhëzues: Informacion për pacientin

MBROTIR L tableta 65 mg

Jodur kaliumi

Lexoni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara përdorimit të këtij bari, sepse përmban informacion të rëndësishëm për ju.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund t'ju nevojitet ta lexoni përsëri më vonë.
- Nëse keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është vetëm për ju. Mos ua jepni të tjerëve. Mund t'i dëmtojë ata, edhe nëse simptomat e tyre janë të njëjta me tuajat.
- Nëse vëreni ndonjë efekt anësor, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Këtu përfshihet çdo efekt i mundshëm anësor që nuk është përmendur në këtë fletëudhëzues. Shihni seksionin 4.

Çfarë përmban ky fletëudhëzues

1. Çfarë është MBROTIR L dhe përse përdoret
2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni MBROTIR L
3. Si ta merrni MBROTIR L
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani MBROTIR L
6. Përmbajtja e paketës dhe informacione të tjera

1. Çfarë është MBROTIR L dhe përse përdoret

Çfarë është MBROTIR L

MBROTIR L përmban lëndën vepruese “jodur kaliumi”. Joduri i kaliumit është një komponim kimik, medikament dhe shtesë ushqimore.

Joduri i kaliumit është një agjent bllokues i tiroides që përdoret për të parandaluar dëmtimin e shkaktuar nga jodi radioaktiv.

Përse përdoret MBROTIR L

MBROTIR L përdoret në rastet e aksidenteve bërthamore ose aksidenteve të reaktorëve bërthamorë, për të parandaluar përthithjen e jodit radioaktiv nga tiroidja.

Në rastin e aksidenteve të reaktorëve bërthamorë, mund të ketë çlirim të jodit radioaktiv. Nëse ndodh kontaminimi, jodi radioaktiv përthithet nga tiroidja. Përthithja e jodit radioaktiv nga tiroidja parandalohet nga marrja e jodit joradioaktiv (p.sh. në formën e jodurit të kaliumit) përpara ose gjatë kontaminimit.

Si funksionon MBROTIR L

Kur merret nga dikush që është ekspozuar ndaj jodit radioaktiv, joduri i kaliumit mund të parandalojë dëmtimin në gjëndrën tiroide duke e ngopur atë me jod joradioaktiv, duke bllokuar në këtë mënyrë marrjen e jodit radioaktiv nga ajri, uji, qumështi dhe burime të tjera të kontaminuara.

2. Çfarë duhet të dini përpara se të përdorni MBROTIR L

Duhet të lexoni fletëudhëzuesin e paketimit të të gjitha produkteve mjekësore që do të merren bashkërisht me MBROTIR L përpara fillimit të trajtimit me MBROTIR L.

Mos e merrni MBROTIR L:

- nëse jeni alergjik ndaj jodurit të kaliumit ose ndaj çdo përbërësi tjetër të këtij bari, të përmendur në seksionin 6. Nëse mendoni se mund të jeni alergjik, këshillohuni me mjekun tuaj.
- nëse keni një sëmundje autoimune që përfshin të kruara dhe fluska në lëkurë (dermatitis herpetiformis van Dühring)
- nëse keni tiroide mbiaktive, që prodhon hormone të tepërta të tiroides (hipertireozë).
- nëse keni një çrregullim të mureve të enëve të gjakut (vaskulit hipokomplementemik)

Nëse ndonjëra nga këto pika lidhet me ju, mos përdorni MBROTIR L. Flisni me mjekun tuaj nëse jeni i/e pasigurt.

Paralajmërime dhe përkujdesje paraprake

Flisni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara përdorimit të MBROTIR L nëse:

- keni një tumor malinj në tiroide apo nëse mjeku juaj supozon se keni një të tillë,
- keni ngushtim të trakesë (që shkakton probleme me frymëmarrjen). Përdorimi i MBROTIR L mund ta përkeqësojë këtë problem,
- po trajtoheni ose jeni trajtuar më parë për probleme me tiroiden,
- keni një problem specifik me tiroiden tuaj, të quajtur autonomi e tiroides, dhe nuk jeni duke marrë trajtim për të,
- keni probleme me veshkat.
- keni probleme ose po merrni trajtim për probleme të gjëndrave mbiveshkore,
- po vuani nga dehidratimi ose ngërçi për shkak të nxehtësisë së lartë,
- po merrni ndonjërin nga barnat e renditura në seksionin “Barna të tjera dhe MBROTIR L”.

Nëse ndonjë prej rasteve të mësipërme vlen për ju, flisni me mjekun tuaj përpara fillimit të trajtimit.

Fëmijët

Foshnjat disa javëshe duhet të vizitohen nga mjeku sa më parë të jetë e mundur pas marrjes së MBROTIR L, në mënyrë që funksioni i tiroides së tyre të monitorohet nga afër.

Barna të tjera dhe MBROTIR L

Tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke përdorur ose keni përdorur së fundmi apo mund të përdorni barna të tjera. Arsyeja është se MBROTIR L mund të ndikojë në mënyrën e funksionimit të disa barnave të tjera. Gjithashtu, disa barna të tjera mund të ndikojnë në mënyrën e funksionimit të MBROTIR L.

Në veçanti, i thoni mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ndonjë prej medikamenteve të mëposhtme:

- medikamente që pengojnë funksionin e tiroides; kur merren njëkohësisht me MBROTIR L, duhet të monitoroheni nga afër nga një mjek,

- captopril ose enalapril; këto medikamente mund të shkaktojnë rritje të niveleve të kaliumit në gjak,
- quinidine; efekti i quinidines në zemër rritet nga MBROTIR L,
- diuretikë kursyes të kaliumit (“shkarkues”) si amiloride ose triamterene; këto medikamente mund të shkaktojnë nivele të rritura të kaliumit në gjak.

Përdorimi i MBROTIR L mund të ndikojë terapinë me radiojod dhe rezultatet e testeve të tiroides.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji

Nëse jeni shtatzënë ose nëse ushqeni fëmijën me gji, mendoni se mund të jeni shtatzënë ose nëse planifikoni një shtatzëni, këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj përpara se të merrni këtë bar.

Gratë shtatzëna nuk duhet të marrin më shumë sesa një dozë me 2 tableta. Nëse MBROTIR L merret në fazat e vonshme të shtatzënisë, rekomandohet të kontrollohet funksioni i tiroides së të sapolindurit.

Gratë që ushqejnë me gji nuk duhet të marrin më shumë sesa një dozë me 2 tableta.

Joduri del në qumështin e gjirit, por sasia nuk është e mjaftueshme për të mbrojtur foshnjën plotësisht. Prandaj, tabletat e jodurit duhet t’i jepen edhe foshnjës.

(Shihni seksionin 3 “Si ta merrni MBROTIR L”)

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

MBROTIR L nuk ka ndikim tek aftësitë e drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive.

3. Si ta merrni MBROTIR L

Tabletat MBROTIR L mund të merren vetëm në rastet e aksidenteve bërthamore dhe nëse njoftohen nga autoriteti përkatës, p.sh. përmes radios ose televizorit.

Mos i merrni këto tableta pa rekomandim.

Përdoren gjithmonë këtë medikament saktësisht siç përshkruhet në këtë fletëudhëzues ose sipas udhëzimit të mjekut ose farmacistit tuaj. Nëse jeni i/e pasigurt, duhet të këshilloheni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Për mbrojtje maksimale, është e nevojshme që tabletat të merren sa më parë të jetë e mundur (mundësisht brenda dy orësh) nga momenti i njoftimit të çlirimit të jodit radioaktiv.

Megjithatë, është gjithsesi e dobishme të merren tabletat deri në 8 orë pas ekspozimit ndaj jodit radioaktiv.

Tabletat gëlltiten të plota. Për foshnjat që ushqehen me gji, tabletat mund të shtypen ose të treten në ujë, shurup ose lëngje të ngjashme. Mund të duhen deri në 6 minuta që tabletat të treten plotësisht. Sigurohuni që tabletat të jenë tretur plotësisht përpara se t’ia jepni fëmijës suaj.

Doza e rekomanduar është:

Të rriturit dhe fëmijët mbi moshën 12 vjeç:	2 tableta
Fëmijët 3-12 vjeç:	1 tabletë
Fëmijët 1 muajsh deri në 3 vjeç:	½tablete
Të sapolindurit dhe foshnjat nën 1 muajsh:	¼ tablete
Gratë shtatzëna (të të gjitha moshave):	2 tableta
Gratë që ushqejnë me gji (të të gjitha moshave):	2 tableta

Kjo dozë siguron edhe mbrojtjen e fetusit.

Të sapolindurit, gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë me gji, si dhe të rriturit mbi moshën 60 vjeç, nuk duhet të marrin më shumë sesa një dozë të vetme.

Marrja e një doze të vetme si më sipër mbron nga përthithja e mundshme e jodit radioaktiv.

Nëse çlirimi i jodit radioaktiv vijon (mbi 24 orë) me ekspozim të përsëritur, nga konsumi i ushqimeve ose ujit të pijshëm të kontaminuar dhe nëse evakuimi nuk është i mundur, mund të nevojitet një dozë tjetër.

Tableta mund të ndahet në doza të barabarta.

Nëse merrni më shumë MBROTIR L sesa duhet

Marrja e më shumë MBROTIR L nga sa përcaktohet më lart nuk rrit efektin mbrojtës. Nëse keni marrë shumë MBROTIR L, mund të ndodhë helmim nga jodi me efekte anësore të rënda, si problemet e frymëmarrjes dhe zemrës.

Nëse keni marrë shumë MBROTIR L, kontaktoni menjëherë mjekun tuaj.

4. Efektet e mundshme anësore

Sikurse të gjitha barnat, ky bar mund të shkaktojë efekte anësore edhe pse jo te çdo person.

Të rralla (mund të prekin 1 në 1 000 persona):

- Skuqje e përkohshme e lëkurës

Të panjohura (shpeshtësia nuk mund të llogaritet nga të dhënat e disponueshme):

- Reaksione mbindjeshmërie, si ënjtja e gjëndrave të pështymës, dhimbje koke, fishkëllimë ose kollë dhe shqetësime të stomakut
- Çrregullime autoimune të shaktuara nga jodi (sëmundja Grave, sëmundja Hashimoto), struma nodulare e dëmshme dhe hiperfunksion ose hipofunksion i përkohshëm i tiroides i shaktuar nga jodi
- Gjëndër tiroideje mbiaktive (karakterizohet nga rënie në peshë, reduktim i oreksit, intolerancë ndaj nxehtësisë dhe djersitje e shtuar), inflamacion i tiroides, gjëndër tiroideje e zmadhuar me ose pa zhvillim të miksedemës (një problematikë ku ndodh trashje e lëkurës

- dhe indeve të trupit, më e theksuar në fytyrë)
- Depresion, nervozizëm, impotencë dhe përgjumje (pas marrjes së vazhdueshme)
 - Sialadenit (inflamacion i gjëndrave të pështymës), shqetësime gastrointestinale

Raportimi i efekteve anësore

Nëse vëreni ndonjë efekt anësor, flisni me mjekun, farmacistin ose infermierin tuaj. Këtu përfshihet çdo efekt i mundshëm anësor që nuk është përmendur në këtë fletëudhëzues. Gjithashtu, ju mund t'i raportoni efektet tuaja anësore drejtpërdrejt në sistemin kombëtar të raportimit. Nëpërmjet raportimit të efekteve anësore, ju mund të ndihmoni në zgjerimin e informacionit lidhur me sigurinë e këtij bari.

5. Si ta ruani MBROTIR L

Mbajeni këtë bar larg fëmijëve.

Mos e përdorni barin pas datës së skadimit të shënuar në karton pas “EXP”. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të muajit përkatës.

Mos e ruani në temperatura mbi 25°C.

Mbajeni në paketimin origjinal me qëllim që ta mbroni nga drita dhe lagështia.

Mos e përdorni këtë bar nëse vini re ndonjë dëmtim ose shenjë ndërhyrjeje në paketim.

Mos hidhni barnat nëpërmjet ujërave të ndotura ose mbetjeve shtëpiake. Pyesni farmacistin tuaj për mënyrën e hedhjes së barnave të panevojshme. Këto masa do të ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit.

6. Përmbajtja e paketës dhe informacione të tjera

Çfarë përmban MBROTIR L

- Lënda vepruese është joduri i kaliumit. Çdo tabletë përmban 65 mg jodur kaliumi, i barasvlershëm me 50 mg jod.
- Përbërësit e tjerë janë:hidroksipropil metil celulozë 4000 mPa, celulozë mikrokristalinë, kroskarmelozë natrium, trisodium citrate 2-hydrate, dhe stearat magnezi.

Si duket MBROTIR L dhe përmbajtja e paketës

Tabletat janë në ngjyrë të bardhë në të verdhë, rumbullake, me sipërfaqe të lëmuar, pa asnjë defekt.

Shishe plastike që përmban 2, 6, 10, 20 ose 100 tableta.

Jo të gjitha përmasat e paketës mund të ofrohen në treg.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim

LEKLI sh.p.k

Rr. “Reshit Petrela”

Nd. 7/143, 1057 Tiranë,

Shqipëri

Prodhuesi

LEKLI sh.p.k

Rr. “Reshit Petrela”

Nd. 7/143, 1057 Tiranë,

Shqipëri

Rishikimi i fundit i këtij fletëudhëzuesi u krye në 03/2022